

## **Komunikatë për Medie**

Prishtinë, 2 dhjetor 2013

Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës do t'i hapet rruga për të qenë pjesë e Sindikatës Evropiane. Në takimin e sotëm ndërmjet përfaqësuesit të BSPK-së dhe përfaqësuesit të Konfederatës Evropiane, u premtua se BSPK do të ndihmohet për të qenë anëtare e kësaj Konfederate, duke u përfshirë në projektet në vendet e rajonit.

Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Haxhi Arifi, tha se nuk ka munguar bashkëpunimi me Sindikatat Evropiane, por duke mos qenë pjesë e Konfederatës Evropiane, BSPK-ja ka hasur në vështirësi të ndryshme. Ai shpreson që së shpejti BSPK do të bëhet anëtare e sindikatës së Konfederatës Evropiane.

“Ne kemi biseduar që vitin e ardhshëm do të mbajmë një konferencë ndërkombëtare këtu në Kosovë. Ka qenë shumë e vështirë të bëhet diçka në atë drejtim. Këta na kanë ofruar gjithmonë që të jemi në mesin e të gjitha shteteve të rajonit edhe në Bruksel në takimet që mbahen, pavarësisht që nuk jemi në Konfederatën Evropiane”, e citon rtk atë.

Përfaqësuesi i Sindikatave të Konfederatës Evropiane, Peter Seideneck, shprehu keqardhjen që nuk ka parë ndonjë ndryshim për kushtet e BSPK-së, duke përmendur vështirësitë me të cilat ballafaqohen sindikatat në Kosovë. Ai tha se është në Kosovë për të ndihmuar BSPK-në në proceset integruese në BE.

“Ne do të krijojmë një plan të punës ku Sindikatat Evropiane do të ndihmojnë BSPK-në, që të përgatitë një agjendë evropiane. BSPK-ja ka qenë gjithmonë pjesë e projekteve rajonale dhe agjenda e këtij projekti është shumë e qartë: dialogu social, legjislacioni i punës, të drejtat e punëtorëve, privatizimi, korrupsioni, ekonomia, politikat sociale si dhe siguria në vendet e punës.”

Në këtë projekt rajonal përfshihen Kosova, Maqedonia, Mali i zi, Bosnja e Hercegovina, Serbia, ndërsa ekspertë të këtij projekti janë nga Sllovenia dhe Kroacia.